

REPUBLIKA E SHQIPERISE
“ART EKSPORT IMPORT” SH.A.
TIRANE

PROCES-VERBAL
I Mbledhjes se Keshillit MBIKQYRES

Ne Tirane, sot me date 23.12.1999, ora 11.30, ne seline e shoqerise “Art Eksport Import” sh.a. mbahet mbledhja e Keshillit Mbiqyres te kesaj shoqerise me kete rend dite:

1. **Miratimi i strukture organike te shoqerise**
2. **Emerimi i Drejtorit te shoqerise**
3. **Te ndryshme**

Ne mbledhje marrin pjese:

- | | |
|--------------------------|-----------------|
| 1. znj. Ina Aleks | Kryetare |
| 2. z. Fjodor Gaba | Anetar |
| 3. z. Gjergji Thomollari | Anetar |

Proces-verbalin e mbledhjes e mban sekretarja znj. Gentiana Jorgji.

E merr fjalen znj. Ina Aleks e cila thote se z. Spiro Spiri me cilesine zv. Drejtorit te shoqerise ka paraqitur per miratim perpara Keshillit Mbiqyres strukturen organike te shoqerise “Art Eksport Import”. Ne shoqeri jane tridhjetedy punonjes te shperndare sipas strukturave perkatese.

Kryetarja propozon qe kjo strukture organike te miratohet nga Keshilli Mbiqyres. Propozimi hidhet ne vote dhe miratohet me 100 % te votave te anetareve te pranishem.

Kalohet per diskutim ne piken e dyte te rendit te dites.

Mqs z. Niqifor Alikaj, Drejtori aktual i shoqerise ka dale ne pension, znj. Ina Aleks propozon qe te zgjidhet si Drejtor i shoqerise “Art Eksport Import” sh.a. z. Koço Kokedhima.

Propozimi hidhet ne vote dhe miratohet me 100 % te votave te anetareve te pranishem.

Ne piken te ndryshme, propozohet qe mbledhjet e Keshillit Mbiqyres te shoqerise te mbahen jo me pak se nje here ne dy muaj dhe caktohet edhe shperblimi per anetaret e ketij keshilli.

Me kaq mbledhja konsiderohet e mbyllur.

Ky proces-verbal nenshkryhet nga Kryetarja e Keshillit Mbiqyres dhe nga sekretarja.

Tirane, me: 23.12.1999

KRYETARE

Ina Aleks
(INA ALEKSI)



SEKRETARE

Gentiana Jorgji
(GENTIANA JORGJI)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
"ART EKSPORT IMPORT" SH.A.
Rr. "4 Shkurti" Nr. 6
TIRANE

Tirane, me: 23.12.1999

VENDIM NR. 2

I KESHILLIT MBIKOYRES TE "ART EKSPORT IMPORT" SH.A.

Keshilli Mbiqyres i shoqerise "Art Eksport Import" sh.a. pasi mori ne shqyrtim rendin e dites se mbledhjes,

V E N D O S I:

1. Te emeroje ne detyren e Drejtorit te shoqerise "Art Eksport Import" sh.a. z. Koço Kokedhima, qe zevendeson ne kete detyre z. Niqifor Alikaj.
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PER KESHILLIN MBIKOYRES

KRYETARE

(IN ALBANSI)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "ART EKSPORT IMPORT" SH.A

Nr. ext Prot

Tiranë, më 15/12/2009

KËRKESË

Drejtuar: Këshillit Mbikqyrës

Lënda: Kërkesë për miratim dorëheqje nga detyra e administratorit të Shoqërisë
"Art Eksport -Import" sh.a

Të nderuar kolegë,

Në cilësinë e Administratorit të shoqërisë si dhe duke u bazuar në detyrimin ligjor për të raportuar, po ju paraqes raportin e mëposhtëm:

Duke qenë se gjatë kryerjes së funksionit si Administrator shoqërie kam ndeshur pengesa në ushtrimin e kompetencave të mia si Administrator shoqërie të krijuara nga aksionari Ministria Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës (METE) siç mund të përmend shprehimisht: refuzimin nga aksionari METE për të diskutuar për pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit të ekspertit kontabël për vitin financiar 2008 me arsyetimin e përmendur në Raportin e datës 10.12.2009 paraqitur organit të Këshillit Mbikqyrës, refuzim për të marrë pjesë në diskutimin e organizimit të shoqërisë me organe të reja (në përshtatje me ligjin tregtar në fuqi) siç mund të përmend konkretisht refuzimin e ushtrimit të së drejtës së votës për emërimin e organit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë, si dhe pengesa të tjera të kësaj natyre. Mund të shprehem se refuzimi në formë shkresore nga aksionari METE për secilin rast mosveprimi është shpjeguar me të njëjtën arsyetim të përmendur në raportin e datës 10.12.2009 dhe paraqitur për tu vlerësuar Këshillit Mbikqyrës.

I gjendur në këto kushte, ku interesat e shoqërisë duhet të bashkërendohen nga të dy aksionarët e shoqërisë, jo vetëm të njërit prej tyre dhe në kushtet e mosveprimit të njërit prej aksionarëve dhe mos kryerjes së angazhimit individual në një pjesëmarrje kapitali me kontribut të përbashkët dhe përpjestimor të të dy aksionarëve, ku të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pjesëmarrje janë të barabarta për secilin aksionar, e konsideroj të arsyeshme të jap dorëheqjen nga funksioni i Administratorit të shoqërisë pasi nuk mund të vazhdoj të ushtoj kompetencat ligjore në të tilla kushte.

I paraqes këtë raport Këshillit Mbikqyrës dhe i kërkoj që të mblidhet brenda muajit Dhjetor në mënyrë që të vlerësojë situatën dhe të më miratojë kërkesën për dhënie dorëheqje pasi në këto kushte nuk mund të kryej më funksionet e Administratorit në shoqërinë Art Export Import pas datës 31.12.2009.

Për shoqërinë "Art Export Import"
Koço KOKËDHIMA



“Art Eksport Import” Sh.a

VENDIM NR. 1 dt.25.07.2011

I

KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Në Tiranë, sot më dt. 25/07/2011, ne adresen Rr. “Ismail Qemali”, Pall. „Abissnet“, u mbajt mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Art Eksport Import” sh.a., e cila pasi konstatoi se Administratori të shoqërisë “Art Eksport Import” sh.a. ka dhene doreheqjen nga ushtrimit të detyrës, me unanimitet :

VENDOSI



1. Të emërojë Znj. Magdaleni KOKËDHIMA, në detyrën e Administratores së shoqërisë “Art Eksport Import” sh.a.
2. Autorizohen juristet Znj. Matilda Fetau dhe Z. Fatos Braja, qe vec e vec ose te dy sebashku, per depozitimim ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit te ketij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sot, më dt. 25/07/2011.

Për Këshillin Mbikëqyrës

Erardi Daberdaku

Andi Derhemi

Armanda Milushi



SHOQËRIA “ART EKSPORT IMPORT” SHA
NUIS: J61828016G
ADRESA E SELISË: 5 MAJI, ISH KIMIKJA, TIRANË

VENDIM NR.1
DATË 27.03.2019
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË “ART EKSPORT IMPORT” SHA

Sot, më datë 27.03.2019, ora 12:00, në adresën: Rruga “Ismail Qemali”, Pallati 18, Kati II-të, Tiranë, sipas njoftimit drejtuar aksionarit Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën datë 04.03.2019, protokolluar pranë kësaj Ministrie me Nr.3588 Prot. më datë 04.03.2019, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “Art Eksport Import” sha.

Në këtë mbledhje është i pranishëm vetëm njëri prej aksionarëve të shoqërisë dhe konkretisht:

1. Shoqëria “2K Group”sh.p.k, e cila zotëron 51% të kapitalit të shoqërisë “Art Eksport Import”sha, përfaqësuar personalisht nga ortakët e saj, konkretisht:
 - Z. Koço Kokëdhima, i cili zotëron 35% të kapitalit të shoqërisë;
 - Znj. Brixhilda Kokëdhima, e cila zotëron 35% të kapitalit të shoqërisë,
 - Znj. Herjeta Deliaj, e cila zotëron 30% të kapitalit të shoqërisë.

Konstatohet se aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotërues i 49% të kapitalit të shoqërisë ka marrë rregullisht dijeni për mbajtjen e mbledhjes sipas njoftimit datë 04.03.2019, protokolluar pranë kësaj Ministrie me Nr.3588 Prot. më datë 04.03.2019.

Mbledhja zhvillohet duke respektuar kuorumin e përfaqësimit, pasi është i pranishëm aksionari që përfaqëson më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë “Art Eksport Import”sha.

Në bazë të nenit 144 dhe 145 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Në përputhje me njoftimin, rendi i ditës është si më poshtë:

- 1- Emërimi i anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë;
- 2- Të ndryshme sipas propozimeve.

Për sa më sipër, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, pasi diskutoi çështjen e përfshirë në rendin e ditës,

VENDOSI:

1. Të riemërojë në detyrën e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë “Art Eksport Import” s për një periudhë kohe 3(tre) vjeçare, duke filluar ky afat nga data 27.03.2019, anëtarën:

- **Znj. Merita Shaqelli.**

2. Të largojë nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës, Znj. Anisa Kotorri për shkak të mbarimit të afatit të emërimit të saj më datë 10.02.2018 dhe Z. Fredi Dervishi për shkak të mbarimit të afatit të emërimit të tij më datë 24.04.2018, dhe të emërojë në vend të tyre për një periudhë kohë 3 (tre) vjeçare, duke filluar ky afat nga data 27.03.2019:


- **Znj. Vjoalba Bengu, identifikuar nga letërnjoftimi me nr.personal J46114065T;**
- **Znj. Vjola Cekaj, identifikuar nga letërnjoftimi me nr.personal I96104008B.**

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
Shoqëria "2 K Group" sh.p.k
Përfaqësuar nga Ortakët

Z. Koço KOKËDHIMA



Znj. Brixhilda KOKËDHIMA



Znj. Herjeta DELIAJ



SHOQËRIA "ART EKSPORT IMPORT" SH.A.

NUIS: J61828016G

ADRESA E SELISË: 5 MAJI, ISH KIMIKE, TIRANË

VENDIM NR. 1

DATË 28.03.2019 I KËSHILLIT MBIKQYRËS TË SHOQËRISË
"ART EKSPORT IMPORT" SH.A.

Sot, më datë 28.03.2019, ora 12:00 në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati 18, Tiranë, mbahet mbledhja e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Art Eksport Import" sh.a. Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë si më poshtë:

- Znj. Merita SHAQELLI;
- Znj. Vjoalba BENGU;
- Znj. Vjola CEKAJ.

Kjo mbledhje e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë mbahet për të diskutuar çështjen e përfshirë në rendin e ditës si më poshtë:

1. Rimërimin e Znj. Magdaleni Kokëdhima në detyrën e Administratores së shoqërisë.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, pasi konstatuan se Znj. Magdaleni Kokëdhima i ka mbaruar afati i qëndrimit në detyrën e Administratores së shoqërisë,

VENDOSËN:

- 1- Të riemërojnë Znj. Magdaleni Kokëdhima, identifikuar me leternjoftimin nr. 030020453, në detyrën e administratores së shoqërisë "Art Eksport Import" sh.a. Afati i qëndrimit në këtë detyrë është për një periudhë kohore 3(tre) vjeçare, duke filluar ky afat nga data e këtij vendimi.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi sot, më datë 28.03.2019.

KËSHILLI MBIKQYRËS

1. Merita SHAQELLI



2. Vjoalba BENGU

Merita-Shaqelli
Vjoalba Bengu

3. Vjola CEKAJ

Vjola Cekaj

